



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 42, datë 25.09.2024

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:

“OLIVIO RESORT”, KOMPLEKS ME FUNKSION REZIDENCIAL DHE HOTELERI
ME 1, 2, 3, 4, 5 DHE 6 KATE MBI TOKË DHE ME 3 KATE NËNTOKË, ME
VENDNDODHJE NË GJILEK, BASHKIA HIMARË

Në mbështetje të neneve 27, 28 Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” e ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Halisof” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Olivio Resort”, Kompleks me funksion rezidencial dhe hoteleri me 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 kate mbi tokë dhe me 3 kate nëntokë, me vendndodhje në Gjilek, Bashkia Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Halisof” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Himarë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TUIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
BLENDI GONXHIJA



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 12/12/2025